



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA KUKËS**  
DREJTORIA FINANCËS DHE BUXHETIT

**P/VENDIM**

Nr. 17 Datë 22.02.2024

PËR

**MIRATIMIN E RAPORTIT TË KONSOLIDUAR TË MONITORIMIT TË BUXHETIT TË BASHKISË KUKËS PËR PERIU DHËN JANAR – DHJETOR 2023**

Bazuar në ligjin Nr.139/2015, të miratuar me datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 8/2, 9/1/1.3/c, 54, ligjin Nr.44/2015, të miratuar me datë 30.04.2015 “Kodi i Proçedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, ligjin Nr.68/2017, të miratuar me datë 27.04.2017 “Per financat e veteqeverisjes vendore”, nenet 7 dhe 48, ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, (i ndryshuar), udhëzimin e Ministrise se Financave Nr.2, datë 06.02.2012 “Për proçedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, (i ndryshuar), udhëzimit nr.22 date 30.07.2018 “Për proçedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimin Nr. 6, datë 28.02.2023 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2024-2026”, Vendimin e Këshillit Bashkiak Kukës Nr.82 datë 23.12.2022 “Për miratimin e Kalendarit të aktiviteteve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 dhe të buxhetit vjetor 2024”, Vendimin e Këshillit të Bashkisë Kukës Nr.80 date 23.12.2022, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2023”, i propozojmë Këshillit të Bashkisë Kukës për:

**MIRATIM:**

1. Raportin e konsoliduar të zbatimit të buxhetit të Bashkisë Kukës për periudhën një vjeçare **Janar – Dhjetor 2023**, bashkëngjitur këtij projekt - vendimi.

**KRYETARI**

Albert HALILAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK KUKËS

VENDIM

Nr. 22 Datë 03.04.2024

PËR

MIRATIMIN E RAPORTIT TË KONSOLIDUAR TË MONITORIMIT TË BUXHETIT TË  
BASHKISË KUKËS PËR PERIUdhËN JANAR-DHJETOR 2023

Këshilli Bashkiak Kukës, në mbledhjen e tij të datës së mësipërme, pasi shqyrtoi projektvendimin dhe relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, si dhe bazuar në ligjin Nr.139/2015, të miratuar me datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 8/2, 9/1/1.3/c, 54, ligjin Nr.44/2015, të miratuar me datë 30.04.2015 “Kodi i Proçedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, ligjin Nr.68/2017, të miratuar me datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenet 7 dhe 48, ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, (i ndryshuar), udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr.2, datë 06.02.2012 “Për proçedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, (i ndryshuar), udhëzimit nr.22 date 30.07.2018 “Për proçedurat standarte të monitorimit të buxhetit të njësisve të vetëqeverisjes vendore”, (i ndryshuar), Udhëzimin Nr.6 datë 28.02.2023 “Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesem Vendor 2024-2026”, Vendimin e Këshillit Bashkiak Kukës Nr.82 datë 23.12.2022 “Për miratimin e Kalendarit të aktiviteteve të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2024-2026 dhe të buxhetit vjetor 2024”, Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 80, datë 23.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2023,

VENDOSI

1. Të miratojë raportin e konsoliduar të zbatimit të buxhetit të Bashkisë Kukës për periudhën një vjeçare **Janar- Dhjetor 2023**, bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

KRYETARI I KËSHILLIT



Shpallur me datë 03.04.2024

Vota Pro 20

Vota Kundër 0

Vota Abstenim 0



## **Raporti vjetor i konsoliduar i zbatimit të buxhetit të Bashkisë Kukës viti 2023**

Buxheti vjetor për vitin 2023 është miratuar me vendimin nr.80 date 23.12.2022, nga Këshilli i Bashkisë Kukës, vendim i cili është konfirmuar nga institucioni i Prefeketit të Qarkut Kukës me shkresën nr 1/36 prot. date 04.01.2023 "Verifikim i ligjshmërisë së akteve", gjithashtu Programi Buxhetor Afatmesëm për Bashkinë Kukës për 2023-2025 është miratuar me vendimin nr.81 date 23.12.2022, nga Këshilli i Bashkisë Kukës, vendim i cili është konfirmuar nga institucioni i Prefeketit të Qarkut Kukës me shkresën nr 1/37 prot. date 04.01.2023 "Verifikim i ligjshmërisë së akteve".

Detajimi i fondeve është realizuar sipas programeve buxhetore ku janë mbajtur parasysh objektivat, qëllimet, produktet dhe përfituesit, nga ku janë përcaktuar dhe buxhetet për çdo program, të parashikuar në PBA për periudhën 2023-2025 dhe Buxhetin vjetor 2023.

Banorët e Bashkisë dhe grupet e interesit kanë dhënë kontributin e tyre dhe janë përfshirë plotësisht në hartimin e buxhetit të vitit 2023 dhe PBA-së 2023-2025, nëpërmjet dëgjimeve publike që janë organizuar nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, përkatësisht në datat 30.05.2022 dhe 15.12.2022, si dhe konsultat publike të zhvilluara në Njësitë Administrative, po kështu zhvillimi i pyetësorit online shpallur në faqen ëeb të Bashkisë kukesi.gov.al dhe mediat sociale të Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak gjatë muajit Janar 2023 që ka qëndruar online deri me datë 15 mars 2023, kanë shërbyer për të marrë në konsideratë propozimet e publikut në prioritetet e zhvillimit me projekte konkrete.

Administrata e Bashkisë Kukës nëpërmjet publikimeve në faqen zyrtare të Bashkisë, në mënyrë të vazhdueshme e ka informuar publikun në lidhje me raportet periodike të monitorimit të buxhetit për periudhat përkatëse.

Raporti i Monitorimit të Zbatimit të Buxhetit të Bashkisë Kukës për periudhën një vjeçare Janar - Dhjetor 2023, ashtu si raportet e mëparshme, është hartuar në përputhje të plotë me udhëzimin nr.22 date 30.07.2018 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisive të vetëqeverisjes vendore".

Raporti i monitorimit të zbatimit të buxhetit është hartuar në mënyrë të përmbledhur dhe ka përmbajtjen si më poshtë:

## Përmbajtja

1. Përmbajtja e raportit dhe lista e dokumentave shoqërues;
2. Hyrje;
3. Hapat e ndjekur në procesin e monitorimit të Buxhetit për periudhën Janar - Dhjetor 2023;
4. Plotësimi i formateve të përcaktuara (të gjitha anekset bashkëlidhur), ku të dhënat janë të rakorduara me Degën e Thesarit Kukës, si për planin e buxhetit dhe realizimin faktik të shpenzimeve sipas Sistemit Informacionit Financiar të Qeverisë (SIFQ);
5. Raporti i shpenzimeve të Bashkisë Kukës **sipas programeve** (Aneksi nr.1)
6. Raporti i shpenzimeve të programeve **sipas artikujve buxhetorë** (Aneksi nr.2)
7. Raporti i **treguesve të performancës** (Aneksi nr.4)
8. Raporti i realizimit të **treguesve financiarë** (Shtojca 5)
9. Relacion shpjegues për çdo format të sipërpërmendur (Shtojca 2)
10. Projektet **e investimeve** të Bashkisë Kukës (Aneksi nr. 5)
11. Raporti për **treguesit e raportit të gjendjes financiare** (Shtojca 6)

## Hyrje

Në mbështetje të nenit 104, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 65, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe nenit 48, të ligjit nr. 68, datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, udhëzimit nr.22 date 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore”, është hartuar dokumenti i Raportit periodik i zbatimit të buxhetit të Bashkisë Kukës për periudhën Janar - Dhjetor 2023, raport i cili informon Anëtarët e Këshillit të Bashkisë Kukës dhe të gjithë qytetarët mbi përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të Administratës së Bashkisë Kukës, mbi përdorimin e fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efizienzë për garantimin e qëndrueshmërisë së sistemit të menaxhimit financiar të Bashkisë Kukës për periudhën Janar - Dhjetor 2023.

Bashkia e Kukësit në aspektin e organizimit administrativ, përfshin në administrimin e vet Bashkinë qendër dhe 14 Njësi Administrative. Duke u bazuar në klasifikimin e ri të zonave urbane dhe rurale, Bashkia Kukës dallohet për karakterin e saj rural. Ajo përfshin 1 qendër urbane dhe 14 zona rurale. Nga pikëpamja e madhësisë së territorit, pjesa më e madhe i përket Njësisë Administrative Malzi, më përkatësisht 16.58 % të territorit e ndjekur nga Grykë Çajë me 9.97 %. Ndërsa pjesën më të vogël e zë qyteti i Kukësit me përkatësisht 1.41 % të totalit të territorit të Bashkisë së Kukësit.

Qyteti i Kukësit është qendra kryesore e Bashkisë Kukës dhe qendra më e rëndësishme si në aspektin ekonomik, administrativ, dhe atë social. Qendra të tjera ekonomike përfshijnë Bicaj, Shtiqën, Shishtavec dhe Shemri (Malzi). Pavarësisht këtyre qendrave ekonomike, Qyteti i Kukësit është vendi ku zhvillohet aktiviteti më i madh prodhues ekonomik, social-kulturor, tregtar, sportiv etj.

Në procesin e monitorimit të Buxhetit të Bashkisë Kukës, sa i takon hapave të ndjekur për periudhën Janar - Dhjetor 2023 janë të njëjtë, kështu janë ndjekur fazat e hartimit dhe përgatitjes së buxhetit dhe hapat që parashikon udhëzimi nr.23 date 30.07.2018 “Për procedurat standarde të hartimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore”, për fazën e parë:

- Përgatitja dhe shpërndarja e kalendarit të Programit Buxhetor Afatmesëm dhe i buxhetit vjetor
- Vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave
- Udhëzimi vjetor i ministrit të Financave dhe Ekonomisë për përgatitjen e buxhetit vendor
- Tavanet përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm
- Udhëzimi i kryetarit të njësisë vendore për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm
- Përgatitja e kërkesave buxhetore mbi bazën e tavaneve paraprake
- Përgatitja e dokumentit të parë të Programit Buxhetor Afatmesëm

Dhe për fazën e dytë:

- Përgatitja dhe shpërndarja e udhëzimit plotësues për Programin Buxhetor Afatmesëm
- Përgatitja e Programit Buxhetor Afatmesëm të rishikuar
- Përgatitja e Programit Buxhetor Afatmesëm përfundimtar

Kurse sa i takon monitorimit dhe procedurave të kryera për monitorimin në Bashkinë Kukës, janë ndjekur me korrektësi hapat që parashikon udhëzimi nr.22 date 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore” si më poshtë:

- Procesi i raportimit mbi performancën për secilin program.
- Ecuria e treguesve të monitorimit të performancës së programeve.
- Raporti mbi të dhënat e treguesve të monitorimit të performancës së programeve.
- Ndryshime të mundshme në strukturën e planit të shpenzimeve.
- Masa e realizimit në përqindje të treguesve të performancës.
- Monitorimi i treguesve të performancës së programeve buxhetore sipas standardeve.
- Relacion shpjegues për mospërputhjet kundrejt planit të periudhës raportuese.
- Masat korigjuese që duhen ndërmarrë në rast mospërputhjeje.
- Masat që kërkojnë vendimmarrje të kryetarit të Bashkisë apo Këshillit të Bashkisë.
- Transferim fondesh ndërmjet njësive shpenzuese të Bashkisë.
- Rishpërndarjet ndërmjet zërave të shpenzimeve korrente, brenda të njëjtit program.
- Raportet e monitorimit të të tre katërmujorëve përmbledhen në një raport përfundimtar monitorimi, i cili i dërgohet Këshillit të Bashkisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Në shkresën e Ministrisë Financave dhe Ekonomisë nr.5773 dt 29.03.2023 “Dërgohen mendimet për Raportin e konsoliduar të monitorimit të buxhetit 2022” për bashkinë Kukës jepen edhe rekomandime disa prej të cilave po i citojmë:

- Të harmonizohet dhe saktësohet informacioni i paraqitur në dokumentin e raportit të monitorimit dhe informacioni në tabelat dhe anekset shoqëruese lidhur me statusin e realizimit të produkteve buxhetore duke dhënë argumenta.

Sa i takon këtij rekomandimi Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Qendra Kombëtare e Biznesit, me shkresën Nr.11593/2 Prot. Datë 28.04.2022 ka dërguar Urdhërin Nr.139 datë 28.04.2022 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për mbylljen e sporteve të shërbimit pranë njësive të qeverisjes vendore dhe bashkimit të dhomave të tregëtisë dhe industrisë dhe/ose të tregëtisë”, kështu që për vitin 2023 shpenzimet e programit 04130-Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) janë 0(zero) lekë.

- Jo vetëm evidentimin e vlerës së detyrimeve të prapambetura të vitit 2022, por edhe planin e hartuar për likuidimin e tyre. Trajtimi i detyrimeve të prapambetura duhet të konsiderohet prioritet.

Raporti katërmujor për Treguesit e gjendjes financiare të Bashkisë Kukës, dërgohet në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë në përputhje me afatet e përcaktuara në udhëzimin nr. 22, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore”, dhe formateve të aneksit 1, dhe aneksit 2, bashkëlidhur udhëzimit. Kështu Bashkia Kukës me shkresën Nr.1063 prot. datë 22.02.2024 ka dërguar “**Dërgim i raportit të vetëvlerësimit, situata financiare Janar – Dhjetor 2023**” të Bashkisë Kukës, sipas tabelave; Aneksi 1: Detyrimet ndaj të tretëve sipas vjetërsisë së tyre, situata financiare normale dhe rastet e vështirësive financiare; Aneksi 2: Treguesit fiskalë të konsoliduar të njësisë të vetëqeverisjes vendore por edhe planin e hartuar për likuidimin e tyre, pasi në shkresën e Ministrisë Financave dhe Ekonomisë nr.5773 dt 29.03.2023 “Dërgohen mendimet për Raportin e konsoliduar të monitorimit të buxhetit 2022” për bashkinë Kukës jepen edhe rekomandime të cilat ne do t’i raportojmë për çdo periudhë katërmujore


- Monitorimi i realizimit të produkteve të realizuara për secilin program buxhetor të konvergojë dhe të jetë në përputhje të plotë me planifikimin buxhetor afatmesëm.

Ne do të mundohemi që ti reflektojmë këto rekomandime në të gjitha raportet, qofshin këto periodike dhe raportin e konsoliduar, që do të hartohen për monitorimin e zbatimit të buxhetit. Të dhënat e treguesve të monitorimit të buxhetit sipas programeve për hartimin e raportit, kanë shërbyer së pari tabelat e anekseve përkatëse dhe ilustrimet me grafiqet si më poshtë dhe bashkë me to dhe relacioni shpjegues i shpenzimeve të Bashkisë Kukës sipas programeve apo siç njihen në raportim aneksi nr.1 dhe shtojca nr.2.

**ANEKSI nr.1 "Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve"**

(në mijë lekë)

Programet		(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)
Titulli		Fakti i vitit paraardhës Viti 2022	PBA Viti 2023	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2023	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2023	Buxheti Vjetor Plani i Periudhes/progresiv	Fakti i Periudhes/progresiv
01110	01110 - Administrata	281,536	267,787	282,409	0	282,409	254,111
06260	06260 - SHERBIMET	304,939	212,035	295,399	0	295,399	259,401
01170	01170 - GJENDJA CIVILE	8,450	8,784	11,299	0	11,299	10,784
03280	03280 - MZSH	57,469	90,667	90,667	0	90,667	65,561
04130	04130 - QKB	1,575	178	178	0	178	0
04240	04240 - UJITJA DHE KULLIMI	10,921	14,032	14,032	0	14,032	6,366
04260	04260 - SHERBIMI PYJOR	9,698	17,482	22,741	0	22,741	13,279
04520	04520 - RRUGET RURALE	36,619	36,619	36,619	0	36,619	27,953
04960	04960 - NDËRMJET LLOGARIVE NË QENDËR	29,834	21,684	22,634	0	22,634	16,900
08130	08130 - SPORTI	4,306	4,306	4,306	0	4,306	4,306
09120	09120 - ARSIMI PARASHKOLLOR	129,939	145,398	174,873	0	174,873	164,895
09230	09230 - KONVIKTI DHE ARSIMI I MESEM	37,140	120,093	130,789	0	130,789	113,747
10430	10430 - KUJDESI SOCIAL	863,360	414,776	908,861	0	908,861	896,560
01620	Fonde komisioner & numerues	0	0	0	0	0	0
01620	Fonde materiale zgjedhore	0	256	5,748	0	5,748	5,748
09240	Bursa Arsimit profesional	212	0	0	0	0	0
03280	Emergjencia civile: Fonde qeverisese	0	8,487	21,642	0	21,642	14,274
06370	Projekte UKK	79,559	82,126	214,543	0	214,543	214,543
<b>Totali i Shpenzimeve të Njësisë</b>		<b>1,855,557</b>	<b>1,444,710</b>	<b>2,236,737</b>	<b>0</b>	<b>2,236,737</b>	<b>2,068,427</b>




Po kështu për hartimin e raportit mbi të dhënat e treguesve të monitorimit të buxhetit sipas artikujve buxhetor, ne kemi përdorur tabelat e anekseve përkatëse dhe ilustrimet me grafiqet si më poshtë dhe bashkë me to dhe relacionin shpjegues të shpenzimeve të Bashkisë Kukës sipas artikujve buxhetor apo siç njihen ndryshe në raportim aneksi nr.2 dhe shtojca nr.2.

## Aneksi 2. Raporti i Shpenzimeve të programeve sipas artikujve

(në mijë lekë)

Art.	Emertimi	(1) Fakti i vitit paraardhës Viti 2022	(2) PBA Viti 2023	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2023	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2023	(5) Buxheti Vjetor Plan i Periudhes/progressiv	(6) Fakti i Periudhes/progressiv
						Buxheti	Fakti
600	Paga	416,709	447,521	466,239	-	466,239	453,886
601	Sigurime Shoqërore	73,099	78,271	80,620	-	80,620	76,609
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	219,469	193,377	245,463	-	245,463	168,170
603	Subvencione	-	-	-	-	-	-
604	Transferta Korente të Brendshme	-	19,484	17,484	-	17,484	2,082
605	Transferta Korente të Huaja	-	-	-	-	-	-
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	867,233	412,580	906,841	-	906,841	895,655
<b>Nen-Totali</b>	<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>1,576,510</b>	<b>1,148,428</b>	<b>1,716,648</b>	<b>-</b>	<b>1,716,648</b>	<b>1,596,401</b>
230	Kapitale të Patrupëzuara	22,709	35,006	45,758	-	30,018	18,138
231	Kapitale të Trupëzuara	226,505	251,145	463,250	-	463,250	446,139
232	Transferta Kapitale	-	-	-	-	-	-
<b>Nen - Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale me financim te brendshem</b>	<b>249,214</b>	<b>286,151</b>	<b>509,008</b>	<b>-</b>	<b>493,268</b>	<b>464,278</b>
230	Kapitale të Patrupëzuara	-	3,072	3,072	-	3,072	3,072
231	Kapitale të Trupëzuara	29,834	8,008	8,008	-	8,008	4,677
232	Transferta Kapitale	-	-	-	-	-	-
<b>Nen - Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale me financim te huaj</b>	<b>29,834</b>	<b>10,131</b>	<b>11,080</b>	<b>-</b>	<b>11,080</b>	<b>7,749</b>
<b>Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>279,047</b>	<b>296,282</b>	<b>520,089</b>	<b>-</b>	<b>520,089</b>	<b>472,026</b>
<b>Totali</b>	<b>Totali (korrente + kapitale)</b>	<b>1,855,557</b>	<b>1,444,710</b>	<b>2,236,737</b>	<b>-</b>	<b>2,236,737</b>	<b>2,068,427</b>




### Relacion shpjegues i shpenzimeve të Bashkisë Kukës sipas programeve (Shtojca 2)

Grafiku dhe tabela e mëposhtme për programin **01110- Menaxhim, Administrimi** tregojnë realizimin, masën e realizimit të objektivave dhe qëllimeve në raport me objektivat e këtij programi ndër të cilat rendisim disa prej tyre:

- Ndërtim i administratës së Bashkisë së Kukësit në funksion të përbushjes së misionit, qëllimeve, objektivave dhe përgjegjësi ndaj qytetarëve.
- Burime njerëzore të trajnuara për kryerjen e funksioneve vendore.
- Sigurimi i shërbimeve mbështetëse për mirëfunksionimin e administratës së Bashkisë Kukës.
- Likuidimi i detyrimeve financiare të Bashkisë ndaj të tretëve.
- Ofrim cilësor i shërbimeve të gjitha administrative.
- Nxitja e punësimit të rinjve, vajza dhe djem përmes lehtësimit të procedurave të regjistrimit të bizneseve dhe zvogëlimi i burokracive tatimore.



Art.	Emertimi	(1) Fakti i vitit paraardhes Viti 2022	(2) PBA Viti 2023	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2023	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2023	(5) Buxheti Vjetor Plani i Periudhes/progr esiv	(6) Fakti i Periudhes/progr esiv
						Buxheti	Fakti
600	Paga	190,136	192,493	192,233	-	192,233	191,713
601	Sigurime Shoqërore	34,559	35,334	35,334	-	35,334	34,868
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	46,624	26,185	28,185	-	28,185	25,747
603	Subvencione					-	-
604	Transferta Korente të Brendshme		10,997	8,997	-	8,997	-
605	Transferta Korente të Huaja					-	-
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	7,378	272	451	-	451	451
<b>Nen -Totali</b>	<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>278,698</b>	<b>265,201</b>	<b>265,200</b>	<b>-</b>	<b>265,200</b>	<b>252,779</b>
230	Kapitale të Patrupëzuara	-	1,500	15,740			
231	Kapitale të Trupëzuara	9,049	1,085	1,469		1,469	1,332
232	Transferta Kapitale	-				-	-
<b>Nen -Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale me financim te brendshem</b>	<b>9,049</b>	<b>2,585</b>	<b>17,209</b>	<b>-</b>	<b>1,469</b>	<b>1,332</b>
230	Kapitale të Patrupëzuara					-	-
231	Kapitale të Trupëzuara					-	-
232	Transferta Kapitale					-	-
<b>Nen -Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale me financim te huaj</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>9,049</b>	<b>2,586</b>	<b>17,209</b>	<b>-</b>	<b>17,209</b>	<b>1,332</b>
<b>Totali (korrente + kapitale)</b>		<b>281,536</b>	<b>267,787</b>	<b>282,409</b>	<b>-</b>	<b>282,409</b>	<b>254,111</b>




Sipas të dhënave nga ditaret e shpenzimeve, ditaret e bankës dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Kukës për periudhën një vjeçare Janar - Dhjetor 2023, shpenzimet në total për këtë program të cilat janë realizuar gjatë kësaj periudhe njëvjeçare janë **254,111** mijë lekë dhe statusi i realizimit të buxhetit për këtë program ka qenë në masën **90 %**, të ndarë sipas artikujve shpenzimet kanë qenë, paga **191,713** mijë lekë ose 99,7%, sigurime shoqërore **34,868** mijë lekë ose 98,7%, mallra dhe shërbime të tjera **25,747** mijë lekë ose 91,4 %, transferime për buxhetin familjar **451** mijë lekë ose 100 %, Investime **1,332** mijë lekë ose 90,7 %.

Grafiku dhe tabela e mëposhtme për programin **06260- Shërbimet publike** në raport me objektivat e këtij programi ndër të cilat rendisim disa prej tyre:

- Përmirësimi i cilësisë së jetës së banorëve, përmes mjediseve të pastra.
- Sigurimi i mjediseve të gjelbëruar.
- Përmirësimi i cilësisë së dekorit, përshtatja me trendin e kohës, përdorimi i shumëfishtë i tij në të gjithë territorin e Bashkisë Kukës.
- Rritja e cilësisë së jetës së banorëve të qytetit dhe zonave rurale,

- Lehtësimi i lëvizjes së këmbësorëve dhe automjeteve.
- Nxitja e zhvillimit industrial në Bashkinë Kukës përmes ngritjes së infrastrukturës.
- Krijimi i një sistemi adresash të saktë për të gjithë territorin e Bashkisë Kukës si mjet për përmirësimin e shërbimeve dhe identitetit të qytetarit.
- Përmirësimi i cilësisë së mirëmbajtjes së varrezave publike.
- Përmirësimi i cilësisë së transportit të administratës në ofrimin e shërbimeve publike

Art.	Emertimi	(1) Fakti i vitit paraardhës Viti 2022	(2) PBA Viti 2023	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2023	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2023	(5) Buxheti Vjetor Plan i Periudhes/progres iv	(6) Fakti i Periudhes/progres iv
						Buxheti	Fakti
600	Paga	47,036	48,435	60,293	-	60,293	59,672
601	Sigurime Shoqërore	7,860	8,271	10,259	-	10,259	9,900
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	107,588	71,899	119,832	-	119,832	98,489
603	Subvencione				-	-	-
604	Transferata Korente të Brendshme				-	-	-
605	Transferata Korente të Huaja				-	-	-
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	107	83	129	-	129	129
<b>Nen -Totali</b>	<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>162,591</b>	<b>128,688</b>	<b>190,513</b>	<b>-</b>	<b>190,513</b>	<b>168,190</b>
230	Kapitale të Patrupëzuara	5,154	11,880	11,880	-	11,880	-
231	Kapitale të Trupëzuara	137,194	71,467	93,006	-	93,006	91,210
232	Transferata Kapitale				-	-	-
<b>Nen -Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale me financim te brendshem</b>	<b>142,348</b>	<b>83,347</b>	<b>104,886</b>	<b>-</b>	<b>104,886</b>	<b>91,210</b>
230	Kapitale të Patrupëzuara				-	-	-
231	Kapitale të Trupëzuara				-	-	-
232	Transferata Kapitale				-	-	-
<b>Nen -Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale me financim te huaj</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>142,348</b>	<b>83,347</b>	<b>104,886</b>	<b>-</b>	<b>104,886</b>	<b>91,210</b>
	<b>Totali (korrente + kapitale)</b>	<b>304,939</b>	<b>212,035</b>	<b>295,399</b>	<b>-</b>	<b>295,399</b>	<b>259,401</b>




Sipas të dhënave nga ditaret e shpenzimeve, ditaret e bankës dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Kukës për periudhën një vjeçare Janar - Dhjetor 2023, shpenzimet në total për programin e **Shërbimeve Publike** të cilat janë realizuar gjatë kësaj periudhe njëvjeçare janë: **259,401** mijë lekë dhe statusi i realizimit të buxhetit për këtë program ka qenë në masën **87,8 %** të ndarë sipas artikujve shpenzimet kanë qenë, paga **59,672** mijë lekë ose **99 %**, sigurime shoqërore **9,900** mijë lekë ose **96,5 %**, mallra dhe shërbime të tjera **98,489** mijë lekë ose **82,2 %**, Investime **91,210** mijë lekë ose **98.1%**.

Grafiku dhe tabela e mëposhtme për programin **01170- Shërbimi i gjendjes civile** në raport me objektivat e këtij programi ndër të cilat rendisim disa prej tyre:

- Ofrimi i një shërbimi cilësor të Gjendjes Civile përmes lëshimit në kohë të dokumenteve bazë siç mund të jenë:
  - a) çertifikata e lindjes;
  - b) çertifikata martesore;
  - c) çertifikata familjare;
  - d) çertifikata e vdekjes;
  - e) dokumenta për letërnjoftimi dhe pasaporta;
  - f) vërtetime banimi, etj.

Art.	Emertimi	(1) Fakti i vitit paraardhës Viti 2022	(2) PBA Viti 2023	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2023	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2023	(5) Buxheti Vjetor Plan i Periudhës/programit Buxheti	(6) Fakti i Periudhës/programit Fakti
600	Paga	7,350	7,400	9,554	-	9,554	9,249
601	Sigurime Shoqërore	1,100	1,200	1,561	-	1,561	1,535
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera		184	184	-	184	-
603	Subvencione				-	-	-
604	Transferta Korente të Brendshme				-	-	-
605	Transferta Korente të Huaja				-	-	-
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ				-	-	-
<b>Nen - Totali</b>	<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>8,450</b>	<b>8,784</b>	<b>11,299</b>	<b>-</b>	<b>11,299</b>	<b>10,784</b>
230	Kapitale të Patrupëzuara	-					
231	Kapitale të Trupëzuara	-					
232	Transferta Kapitale	-					
<b>Nen - Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale me financim te brendshem</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
230	Kapitale të Patrupëzuara	-					
231	Kapitale të Trupëzuara	-					
232	Transferta Kapitale	-					
<b>Nen - Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale me financim te huaj</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
	<b>Totali (korrente + kapitale)</b>	<b>8,450</b>	<b>8,784</b>	<b>11,299</b>	<b>-</b>	<b>11,299</b>	<b>10,784</b>




Sipas të dhënave nga ditaret e shpenzimeve, ditaret e bankës dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Kukës për periudhën një vjeçare Janar - Dhjetor 2023, shpenzimet në total për këtë program të cilat janë realizuar gjatë kësaj periudhe njëvjeçare janë **10,784** mijë lekë dhe statusi i realizimit të buxhetit për këtë program ka qenë në masën **95,4%**, të ndarë sipas artikujve shpenzimet kanë qenë, shpenzime për paga **9,249** mijë lekë, ose **96,8 %**, për sigurime shoqërore **1,535** mijë ose **98,3 %**, dhe transferta per buxhetin familjar **0** mijë lekë.

Grafiku dhe tabela e mëposhtme për programin **03280- Mbrojtja nga zjarri dhe shpëtimi** në raport me objektivat e këtij programi ndër të cilat rendisim disa prej tyre:

- Krijimi i skemës funksionale të burimeve njerëzore dhe logjistike për menaxhimin mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin si dhe plotësimi i kushteve të sigurisë për mbrojtjen kundër zjarrit për të gjithë objektet në pronësi të Bashkisë Kukës.
- Ofrimi i një shërbimi të qëndrueshëm për emergjencat civile në çdo pjesë të territorit të Bashkisë Kukës përmes ngritjes së strukturës së vullnetarëve civilë si pjesë e rëndësishme e strukturave të mbrojtjes civile.


Art.	Emertimi	(1) Fakti i vitit paraardhës Viti 2022	(2) PBA Viti 2023	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2023	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2023	(5) Buxheti Vjetor Plan i Periudhes/Progresit	(6) Fakti i Periudhes/Progresit
						<b>Buxheti</b>	<b>Fakti</b>
600	Paga	39,995	40,259	40,319	-	40,319	33,725
601	Sigurime Shoqërore	7,035	6,827	6,827	-	6,827	5,300
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	10,440	24,420	24,420	-	24,420	7,699
603	Subvencione						
604	Transferta Korente të Brendshme						
605	Transferta Korente të Huaja						
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ		371	311	-	311	311
<b>Pran-Totali</b>	<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>57,469</b>	<b>71,876</b>	<b>71,876</b>	<b>-</b>	<b>71,876</b>	<b>47,034</b>
230	Kapitale të Patrupëzuara						
231	Kapitale të Trupëzuara		18,791	18,791		18,791	18,527
232	Transferta Kapitale						
<b>Nen - Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale me financim te brendshem</b>	<b>-</b>	<b>18,791</b>	<b>18,791</b>	<b>-</b>	<b>18,791</b>	<b>18,527</b>
230	Kapitale të Patrupëzuara						
231	Kapitale të Trupëzuara						
232	Transferta Kapitale						
<b>Nen - Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale me financim te huaj</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>-</b>	<b>18,791</b>	<b>18,791</b>	<b>-</b>	<b>18,791</b>	<b>18,527</b>
<b>Totali</b>	<b>Totali (korrente + kapitale)</b>	<b>57,469</b>	<b>90,667</b>	<b>90,667</b>	<b>-</b>	<b>90,667</b>	<b>65,561</b>



Sipas të dhënave nga ditarët e shpenzimeve, ditarët e bankës dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Kukës për periudhën një vjeçare Janar - Dhjetor 2023, shpenzimet në total për këtë program të cilat janë realizuar gjatë kësaj periudhe njëvjeçare janë: **65,561** mijë lekë dhe statusi i realizimit të buxhetit për këtë program ka qenë në masën **72,3 %**, të ndarë sipas artikujve shpenzimet kanë qenë, shpenzime për paga **33,725** mijë lekë ose **83,6 %**, sigurime shoqërore **5,800** mijë lekë ose **77,6%**, shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera **7,699** mijë lekë ose **31,5%**, dhe transferta per buxhetin familjar **311** mijë lekë ose **100%**. Investime **18.527** mijë lekë

Në planet për **Emergjencat Civile**, që hartohen bazuar në strategjitë për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, dokumentet e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë natyrore, kapacitetet e mbrojtjes civile, edhe përvojat e fituara në menaxhimin e fatkeqësive, përfshihen edhe financimet nga qeveria për familjet e dëmtuara nga fatkeqësitë natyrore në Bashkinë Kukës, që për vitin 2023 nga **21,642** mijë lekë janë bërë shpenzime për këtë program **14,274** mijë lekë ose **66 %** e fondit.


Art.	Emertimi	(1) Fakti i vitit paraardhës Viti 2022	(2) PBA Viti 2023	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2023	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2023	(5) Buxheti Vjetor Plan i Periudhes/progr esiv Buxheti	(6) Fakti i Periudhes/progr esiv Fakti
600	Paga			2,530	-	2,530	2,527
601	Sigurime Shogërore				-	-	-
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera				-	-	-
603	Subvencione				-	-	-
604	Transferta Korente të Brendshme		8,487	8,487	-	8,487	2,082
605	Transferta Korente të Huaja				-	-	-
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ				-	-	-
<b>en-Totali</b>	<b>Shpenzime Korrente</b>		<b>8,487</b>	<b>11,017</b>	<b>-</b>	<b>11,017</b>	<b>4,609</b>
230	Kapitale të Patrupëzuara	-				-	-
231	Kapitale të Trupëzuara	-		10,624		10,624	9,665
232	Transferta Kapitale	-				-	-
<b>Nen - Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale me financim te brendshem</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>10,624</b>	<b>-</b>	<b>10,624</b>	<b>9,665</b>
230	Kapitale të Patrupëzuara					-	-
231	Kapitale të Trupëzuara					-	-
232	Transferta Kapitale					-	-
<b>Nen - Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale me financim te huaj</b>		<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale</b>		<b>-</b>	<b>10,624</b>	<b>-</b>	<b>10,624</b>	<b>9,665</b>
<b>Totali (korrente + kapitale )</b>			<b>8,487</b>	<b>21,642</b>	<b>-</b>	<b>21,642</b>	<b>14,274</b>



Grafiku dhe tabela e mëposhtme për programin **04130- Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB)** në raport me objektivat e këtij programi ndër të cilat rendisim disa prej tyre:

- QKB në Bashkinë Kukës përmirëson klimën e biznesit duke lehtësuar procedurat për regjistrim;
- QKB mundëson aplikimin online për regjistrimin e biznesit dhe për një sërë shërbimesh.

Art.	Emertimi	(1) Fakti i vitit paraardhës Viti 2022	(2) PBA Viti 2023	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2023	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2023	(5) Buxheti Vjetor Plan i Periudhes/programit	(6) Fakti i Periudhes/programit
						Buxheti	Fakti
600	Paga	1,248	160	160	-	160	-
601	Sigurime Shoqërore	227	18	18	-	18	-
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	100	-	-	-	-	-
603	Subvencione				-	-	
604	Transferta Korente të Brendshme				-	-	
605	Transferta Korente të Huaja				-	-	
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ		-	-	-	-	-
<b>en-Totali</b>	<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>1,575</b>	<b>178</b>	<b>178</b>	<b>-</b>	<b>178</b>	<b>-</b>
230	Kapitale të Patrupëzuara	-				-	
231	Kapitale të Trupëzuara	-				-	
232	Transferta Kapitale	-				-	
<b>Nen - Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale me financim te brendshem</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
230	Kapitale të Patrupëzuara				-	-	
231	Kapitale të Trupëzuara				-	-	
232	Transferta Kapitale				-	-	
<b>Nen - Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale me financim te huaj</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Totali (korrente + kapitale)</b>		<b>1,575</b>	<b>178</b>	<b>178</b>	<b>-</b>	<b>178</b>	<b>-</b>




Sipas të dhënave nga ditarët e shpenzimeve, ditarët e bankës dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Kukës për periudhën një vjeçare Janar - Dhjetor 2023, shpenzimet në total për këtë program të cilat janë realizuar gjatë kësaj periudhe njëvjeçare janë 0 lekë, pasi Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Qendra Kombëtare e Biznesit, me shkresën Nr.11593/2 Prot. Datë 28.04.2022 ka dërguar Urdhërin Nr.139 datë 28.04.2022 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për mbylljen e sporteve të shërbimit pranë njësive të qeverisjes vendore dhe bashkimit të dhomave të tregëtisë dhe industrisë dhe/ose të tregëtisë”, kështu që për vitin 2023 shpenzimet e programit 04130- Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) janë 0(zero) lekë.

Grafiku dhe tabela e mëposhtme për programin **04240- Ujitja dhe Kullimi** në raport me objektivat e këtij programi ndër të cilat rendisim disa prej tyre:

- Administrimi i infrastrukturës vendore të ujitjes dhe kullimit të tokave;
- Ndërtimi i veprave të reja të infrastrukturës vendore të ujitjes dhe kullimit;
- Menaxhimi i institucionit në shërbim të këtij funksioni, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;

Art.	Emertimi	(1) Fakti i vitit paraardhës Viti 2022	(2) PBA Viti 2023	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2023	(4) Buxheti Vjetor Plan i Përfunduar Viti 2023	(5) Buxheti Vjetor Plan i Periudhës/progressiv	(6) Fakti i Periudhës/progressiv
						<b>Buxheti</b>	<b>Fakti</b>
600	Paga	1,513	1,533	1,533	-	1,533	1,231
601	Sigurime Shoqërore	352	521	521	-	521	206
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	7,833	10,755	10,755	-	10,755	4,929
603	Subvencione				-	-	-
604	Transferta Korente të Brendshme				-	-	-
605	Transferta Korente të Huaja				-	-	-
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ				-	-	-
<b>Nen-Totali</b>	<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>9,698</b>	<b>12,809</b>	<b>12,809</b>	<b>-</b>	<b>12,809</b>	<b>6,366</b>
230	Kapitale të Patrupëzuara				-	-	-
231	Kapitale të Trupëzuara	1,223	1,223	1,223	-	1,223	-
232	Transferta Kapitale				-	-	-
<b>Nen - Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale me financim te brendshem</b>	<b>1,223</b>	<b>1,223</b>	<b>1,223</b>	<b>-</b>	<b>1,223</b>	<b>-</b>
230	Kapitale të Patrupëzuara				-	-	-
231	Kapitale të Trupëzuara				-	-	-
232	Transferta Kapitale				-	-	-
<b>Nen - Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale me financim te huaj</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>1,223</b>	<b>1,223</b>	<b>1,223</b>	<b>-</b>	<b>1,223</b>	<b>-</b>
	<b>Totali (korrente + kapitale )</b>	<b>10,921</b>	<b>14,032</b>	<b>14,032</b>	<b>-</b>	<b>14,032</b>	<b>6,366</b>




Sipas të dhënave nga ditarët e shpenzimeve, ditarët e bankës dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Kukës për periudhën një vjeçare Janar - Dhjetor 2023, shpenzimet në total për këtë program të cilat janë realizuar gjatë kësaj periudhe njëvjeçare janë: **6,366** mijë lekë dhe statusi i realizimit të buxhetit për këtë program ka qenë në masën **45,4 %**, të ndarë sipas artikujve shpenzimet kanë qenë, paga **1,231** mijë lekë **80,3 %**, dhe sigurime shoqërore **206** mijë lekë **39,4%**, shpenzime operative **4,929** mijë lekë **45,8 %**.

Grafiku dhe tabela e mëposhtme për programin **04260- Menaxhimi i pyjeve** në raport me objektivat e këtij programi ndër të cilat rendisim disa prej tyre:

- Regjistrimin e fondit pyjor dhe kullor në ZRPP;
- Rehabilitim, pyllëzim dhe ripyllëzim të sipërfaqeve, të degraduara, djegura dhe rehabilitimin e kullotave.
- Evidentimi për zjarret e rënë në pyjet dhe kullotat që administrojnë apo kanë në pronësi dhe raportim për të dhënat statistikore, në përputhje me përcaktimet e dispozitave ligjore.
- Parandalimi i gjërryerjes së mëtejshme të tokës pyjore dhe kullimore.

Art.	Emertimi	(1) Fakti i vitit paraardhës Viti 2022	(2) PBA Viti 2023	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2023	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2023	(5) Buxheti Vjetor Plan i Periudhes/progressiv	(6) Fakti i Periudhes/progressiv
						Buxheti	Fakti
600	Paga	1,471	11,055	11,055	-	11,055	9,227
601	Sigurime Shoqërore	352	1,839	1,839	-	1,839	1,296
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	7,833	4,588	4,588	-	4,588	2,755
603	Subvencione				-	-	
604	Transferta Korente të Brendshme				-	-	
605	Transferta Korente të Huaja				-	-	
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	42	-	-	-	-	-
<b>len-Totali</b>	<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>9,698</b>	<b>17,482</b>	<b>17,482</b>	<b>-</b>	<b>17,482</b>	<b>13,279</b>
230	Kapitale të Patrupëzuara	-	-	-	-	-	-
231	Kapitale të Trupëzuara	-	-	5,259	-	5,259	-
232	Transferta Kapitale	-	-	-	-	-	-
<b>Nen - Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale me financim te brendshem</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>5,259</b>	<b>-</b>	<b>5,259</b>	<b>-</b>
230	Kapitale të Patrupëzuara	-	-	-	-	-	-
231	Kapitale të Trupëzuara	-	-	-	-	-	-
232	Transferta Kapitale	-	-	-	-	-	-
<b>Nen - Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale me financim te huaj</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>5,259</b>	<b>-</b>	<b>5,259</b>	<b>-</b>
	<b>Totali (korrente + kapitale)</b>	<b>9,698</b>	<b>17,482</b>	<b>22,741</b>	<b>-</b>	<b>22,741</b>	<b>13,279</b>




Sipas të dhënave nga ditaret e shpenzimeve, ditaret e bankës dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Kukës për periudhën një vjeçare Janar - Dhjetor 2023, shpenzimet në total për këtë program të cilat janë realizuar gjatë kësaj periudhe njëvjeçare janë: **13,279** mijë lekë dhe statusi i realizimit të buxhetit për këtë program ka qenë në masën **58,4 %**, të ndarë sipas artikujve shpenzimet kanë qenë, paga **9,227** mijë lekë ose **83,5 %**, sigurime shoqërore **1,296** mijë lekë ose **70,5 %**, mallra dhe shërbime të tjera **2,755** mijë lekë ose **60,0%**.



Grafiku dhe tabela e mëposhtme për programin **04520- Rrugët rurale** në raport me objektivat e këtij programi ndër të cilat rendisim disa prej tyre:

- Përmirësimi i rrjetit të rrugëve vendore dhe trotuareve në Bashkinë Kukës.
- Lehtësimi i lëvizjes së banorëve të qytetit përmes rehabilitimit të infrastrukturës rrugore
- Nxitja e turizmit në rajon përmes ndërtimit të infrastrukturës rrugore strategjike.
- Lehtësimi i lidhjes së banorëve të bashkisë me pikat e kalimit ndërkombëtar.
- Lehtësimi i lëvizjes së banorëve në zonat e bashkisë përmes pastrimit të rrugëve nga dëborat.
- Lehtësimi i lëvizjes së banorëve në zonat rurale të bashkisë përmes rehabilitimit të infrastrukturës rrugore.

Art.	Emertimi	(1) Fakti i vitit paraardhës Viti 2022	(2) PBA Viti 2023	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2023	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2023	(5) Buxheti Vjetor Plan i Periudhes/progressiv	(6) Fakti i Periudhes/progressiv
						<b>Buxheti</b>	<b>Fakti</b>
600	Paga	6,208	8,564	8,564	-	8,564	7,598
601	Sigurime Shoqërore	646	895	895	-	895	541
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	26,636	16,408	16,408	-	16,408	9,061
603	Subvencione				-	-	
604	Transferta Korente të Brendshme				-	-	
605	Transferta Korente të Huaja				-	-	
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ				-	-	
<b>Nen -Totali</b>	<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>33,490</b>	<b>25,867</b>	<b>25,867</b>	<b>-</b>	<b>25,867</b>	<b>17,201</b>
230	Kapitale të Patrupëzuara				-	-	
231	Kapitale të Trupëzuara	1,223	10,752	10,752	-	10,752	10,752
232	Transferta Kapitale				-	-	
<b>Nen -Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale me financim te brendshem</b>	<b>1,223</b>	<b>10,752</b>	<b>10,752</b>	<b>-</b>	<b>10,752</b>	<b>10,752</b>
230	Kapitale të Patrupëzuara	-	-	-	-	-	-
231	Kapitale të Trupëzuara	-	-	-	-	-	-
232	Transferta Kapitale	-	-	-	-	-	-
<b>Nen -Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale me financim te huaj</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>1,223</b>	<b>10,752</b>	<b>10,752</b>	<b>-</b>	<b>10,752</b>	<b>10,752</b>
	<b>Totali (korrente + kapitale)</b>	<b>34,713</b>	<b>36,619</b>	<b>36,619</b>	<b>-</b>	<b>36,619</b>	<b>27,953</b>




Sipas të dhënave nga ditarët e shpenzimeve, ditarët e bankës dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Kukës për periudhën një vjeçare Janar - Dhjetor 2023, shpenzimet në total për këtë program të cilat janë realizuar gjatë kësaj periudhe njëvjeçare janë: **27,953** mijë lekë dhe statusi i realizimit të buxhetit për këtë program ka qenë në masën **76,3 %**, të ndarë sipas artikujve shpenzimet kanë qenë, paga **7,598** mijë lekë ose **88,7%**, sigurime shoqërore **541** mijë lekë ose **60,5 %**, shpenzime operative per mallra e shërbime te tjera **9,061** mijë lekë ose **55,2 %**, investime **10.752** mijë lekë ose **100%**.

Grafiku dhe tabela e mëposhtme për programin **09120- Arsimi Parashkollor** në raport me objektivat e këtij programi ndër të cilat rendisim disa prej tyre:

- Rritja e efektivitetit të përdorimit të fondeve për arsimin dhe zhvillimi e shfrytëzimi cilësor i infrastrukturës së institucioneve arsimore në Bashkinë Kukës.
- Rritja e cilësisë së jetës kulturore e sportive të bashkisë.
- Zhvillimi i talenteve të reja në fushën e artit dhe kulturës si dhe pasurimi e gjallërimi i jetës kulturore e artistike.
- Promovimi i nxënësve të dalluar në mësimet përmes aktiviteteve kulturore dhe argëtuese.
- Përfshirja e të rinjve në aktivitete rinore me tematika të ndryshme.
- Rritja e cilësisë së mësimdhënies përmes ngritjes/rehabilitimit të infrastrukturës arsimore rishpërndarja më optimale e numrit të nxënësve në shkollat e qytetit të Kukësit.

Art.	Emertimi	(1) Fakti i vitit paraardhës Viti 2022	(2) PBA Viti 2023	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2023	(4) Buxheti Vjetor Plan i Ffishtuar Viti 2023	(5) Buxheti Vjetor Plan i Periudhes/progressiv	(6) Fakti i Periudhes/progressiv
						<b>Buxheti</b>	<b>Fakti</b>
600	Paga	101,586	116,139	116,192	-	116,192	116,091
601	Sigurime Shoqërore	17,485	19,375	19,375	-	19,375	19,331
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	1,407	5,018	5,018	-	5,018	1,775
603	Subvencione				-	-	
604	Transferta Korente të Brendshme				-	-	
605	Transferta Korente të Huaja				-	-	
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	72	161	108	-	108	108
<b>En-Totali</b>	<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>120,551</b>	<b>140,692</b>	<b>140,692</b>	<b>-</b>	<b>140,692</b>	<b>137,305</b>
230	Kapitale të Patrupëzuara				-	-	
231	Kapitale të Trupëzuara	9,389	4,706	34,180	-	34,180	27,589
232	Transferta Kapitale				-	-	
<b>Nen - Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale me financim te brendshem</b>	<b>9,389</b>	<b>4,706</b>	<b>34,180</b>	<b>-</b>	<b>34,180</b>	<b>27,589</b>
230	Kapitale të Patrupëzuara	-	-	-	-	-	-
231	Kapitale të Trupëzuara	-	-	-	-	-	-
232	Transferta Kapitale	-	-	-	-	-	-
<b>Nen - Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale me financim te huaj</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>9,389</b>	<b>4,706</b>	<b>34,180</b>	<b>-</b>	<b>34,180</b>	<b>27,589</b>
<b>Totali (korrente + kapitale)</b>		<b>129,939</b>	<b>145,398</b>	<b>174,873</b>	<b>-</b>	<b>174,873</b>	<b>164,895</b>




Sipas të dhënave nga ditarët e shpenzimeve, ditarët e bankës dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Kukës për periudhën një vjeçare Janar - Dhjetor 2023, shpenzimet në total për këtë program të cilat janë realizuar gjatë kësaj periudhe njëvjeçare janë: **164,895** mijë lekë dhe statusi i realizimit të buxhetit për këtë program ka qenë në masën **94 %**, të ndarë sipas artikujve shpenzimet kanë qenë, paga **116,091** mijë lekë ose **100 %**, sigurime shoqërore **19,331** mijë lekë ose **100 %**, mallra dhe shërbime te tjera **1,775** lekë ose **35 %**, transferime për buxhetin familjar **108** mijë lekë ose **100 %**, investime kapitale **27,589** mijë lekë ose **81 %**.

**09230- Arsimi Parauniversitar dhe Konvikti** në raport me objektivat e këtij programi ndër të cilat rendisim disa prej tyre:

- Rritja e efektivitetit të përdorimit të fondeve për arsimin e mesëm dhe konviktin dhe zhvillimi e shfrytëzimi cilësor i infrastrukturës së institucioneve arsimore për arsimin e mesëm dhe konviktin në Bashkinë Kukës.
- Rritja e cilësisë së jetës kulturore e sportive të bashkisë.
- Zhvillimi i talenteve të reja në fushën e artit dhe kulturës si dhe pasurimi e gjallërimi i jetës kulturore e artistike.
- Promovimi i nxënësve të dalluar në mësimet përmes aktiviteteve kulturore dhe argëtuese.
- Përfshirja e të rinjve në aktivitete rinore me tematika të ndryshme.
- Rritja e cilësisë së mësimdhënies për arsimin e mesëm dhe konviktin përmes ngritjes/reabilitimit të infrastrukturës arsimore rishpërndarja më optimale e numrit të nxënësve në shkollat e qytetit të Kukësit.

Art.	Emertimi	(1) Fakti i vitit paraardhës Viti 2022	(2) PBA Viti 2023	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2023	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2023	(5) Buxheti Vjetor Plan i Periudhes/progr esiv	(6) Fakti i Periudhes/progr esiv
						<b>Buxheti</b>	<b>Fakti</b>
600	Paga	16,775	16,072	16,008	-	16,008	16,005
601	Sigurime Shoqërore	2,898	3,422	3,422	-	3,422	3,224
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	11,007	17,937	19,711	-	19,711	3,753
603	Subvencione				-	-	-
604	Transferta Korente të Brendshme				-	-	-
605	Transferta Korente të Huaja				-	-	-
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	37	42	106	-	106	106
<b>Ven-Totali</b>	<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>30,717</b>	<b>37,473</b>	<b>39,248</b>	<b>-</b>	<b>39,248</b>	<b>23,089</b>
230	Kapitale të Patrupëzuara					-	-
231	Kapitale të Trupëzuara	6,423	82,620	91,541		91,541	90,659
232	Transferta Kapitale					-	-
<b>Nen - Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale me financim te brendshem</b>	<b>6,423</b>	<b>82,620</b>	<b>91,541</b>	<b>-</b>	<b>91,541</b>	<b>90,659</b>
230	Kapitale të Patrupëzuara	-	-	-	-	-	-
231	Kapitale të Trupëzuara	-	-	-	-	-	-
232	Transferta Kapitale	-	-	-	-	-	-
